



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 101/2013
Prishtinë, më 16.4.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Gurakuq Kastrati, Igballe Rexhaj- Jashari dhe Rexhep Bllaca – MTI; Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi dhe Darsei Canhasi – INDEP; Besnik Ramadani – KDI dhe Mehedi Mulaj – KosvaPress- gazetar.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 3.4.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-195, për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë;
4. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-181, për produktet e ndërtimit;
5. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.4.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 3.4.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-195 për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë

Kryetari – Theksoi se sipas Rregullores së Kuvendit, para leximit të parë të projektligjeve, komisionet funksionale i shqyrtojnë në parim projektligjet. Ai kërkoi nga deputetët që të formohet një grup punues prej 3 anëtarëve, për të amendamentuar Projektligjin për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë.

Pas debatit, me gjashtë (6 vota) për, dhe 2 (dy) abstenime, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-195 për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-195, për Tregun e Naftës dhe Produkteve të Naftës në Kosovë.

Grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, ka këtë përbërje: Shaip Muja, raportues, Lutfi Zharku dhe Myzejane Selmani.

4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-181, për produktet e ndërtimit

Kryetari – Tha se grupi punues e ka shqyrtuar Projektligjin për produktet e ndërtimit, dhe ka hartuar disa amendamente, ku ne si Komision, sot do t'i shqyrtojmë. Ai bëri të ditur se kryesues i grupit të punës është z. Hashim Deshishku, pastaj fjalën ia dha për t'i paraqitur amendamentet.

Hashim Deshishku - Tha që grupi punues ka mbajtur një takim dhe ka shqyrtuar këtë projektligj. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsorues të projektligjit dhe për të arsyetuar projektligjin në fjalë, si dhe përfaqësues nga organizata INDEP, që po e mbështesin punën e Komisionit. Deshishku theksoi se grupi i punës gjatë shqyrtimit, i ka hartuar 37 amendamente dhe bëri prezantimin e amendamenteve një nga një.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Shaip Muja - Kërkoj sqarim lidhur me propozimin që e ka sjellë Oda Ekonomike e Kosovës se a mund të zëvendësohet emërtimi i fjalës “produktet me prodhuesit” në tërë tekstin e Projektligjit.

Gurakuq Kastrati, përfaqësues i Ministrisë së tregtisë dhe Industrisë, dha sqarime së në terminologjinë e shikuar është në çdo vend produktet sepse prodhimet finale bëhen produkte.

Kryetari – tha se tani nuk është rasti të lëshohet në vërejtje por të procedohen vetëm ato propozime konkrete.

Komisioni u dakordua që të mbetet fjala “produkte/t” sikurse në projektligj.

Sala Berisha – Shala – Kërkoj sqarim lidhur me **Amendamentin 8, të nenit 8**, pse është zëvendësuar fjala “kur është mundur”, me “kur është e zbatueshme”.

Hashim Deshishku – Në lidhje me këtë, tha që kjo është bërë që të gjejë sa më shumë zbatim në praktike, sepse fjala “kur është e mundur” po lenë hapësirë më të madhe të moszbatimit në praktikë të ligjit.

Komisioni u dakordua që të mbetet fjalia “kur është e zbatueshme” sikurse në projektligj.

Lutfi Zharku – Propozoi që të rishikohet edhe një herë **neni 10**, sa i përket përdorimit të shenjës CE. Ai tha, që grupi punues ka pas dilema për këtë çështje, edhe pse është pajtuar që të fshihet neni 10, pastaj Ministria ka propozuar që të mbetet sikurse në projektligj. Zharku shtoi se është me interes të dihet se a mundet Kosova me vendos shenjën CE, dhe kush e vërteton këtë?

Gurakuq Kastrati, përfaqësues i Ministrisë së tregtisë dhe Industrisë, tha se çdo shtet duhet ta ketë shenjën e vetë, e cila duhet të vendoset në produktet e ndërtimit, por me qenë së është në direktivat BE-së, ne e kemi parë të arsyeshme që ta vendosim shenjën CE, për t’iu përafshuar standardeve të BE-së. Pasi që edhe vendet (shtetet) në rajon i kanë shenjat e veta identifikuese të produkteve të ndërtimit, ne për shembull e kemi shenjën KK. Mirëpo, ai tha se mund të zëvendësohet “shenja CE me konformiteti”.

Kryetari - Propozoi që edhe një herë të mblidhet grupi punues së bashku me përfaqësuesit e MTI-së, në mënyrë që ta analizojnë në hollësi këtë çështje.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-181, për produktet e ndërtimit.

5. Të ndryshme

i) Shqyrtimi i raporteve të Agjencive të pavarura për vitin 2012

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se kanë filluar Agjencitë e pavarura që i raportojnë Komisionit tonë funksional, t’i sjellin raportet vjetore, dhe propozoi që ato të shqyrtohen në mbledhjen e radhës.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që të shqyrtojnë nga një raport në një mbledhje të Komisionit.

ii) Çështjet vijuese

Myzejene Selmani - Propozoi që të organizohet një konferencë apo tryeze më përfaqësuesit e kompanive apo bizneseve, për t'i parë mundësitë se çka mund të bëhet dhe si mund të ndihmohen nga aspekti i legjislacionit

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që në një nga mbledhjet e radhës të caktojnë temën dhe të organizohet një tryezë në bashkëpunim me INDEP.

Kryetari – tha se në javën e ardhme do të bëjmë një vizitë brenda vendit, në ndonjë nga kompanitë vendore dhe të shohim për se afërmi se si janë kushtet më të cilat përballen bizneset.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit